



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____. _____. 2023

VENDIM

Nr. 190, datë 26.04.2023

**PËR
TRANSFERIMIN E PËRHERSHËM TË KANCELARIT TË GJYKATËS SË RRETHIT
GJYQËSOR MAT**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 90 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes në sistemin e drejtësisë”, nenit 80, nenit 83 të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, në vendimin nr. 557, datë 29.12.2022 të KLGJ-së “Për krijimin, kompetencat dhe funksionimin e Komisioneve të Ristrukturimit”, në vendimin nr.129, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër” në vendimin nr. 162, datë 06.04.2023 të KLGJ-së “Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat”, si dhe në vendimin nr. 2355/2, datë 12.04.2023 të Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat,

VENDOSI:

1. Znj. {...}, aktualisht Kancelar në detyrë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, transferohet në mënyrë të përhershme Kancelar në detyrë, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.
2. Efektet e këtij Vendimi fillojnë nga data 01.05.2023.
3. Njoftimin e këtij vendimi Znj. {...} dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR